


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Mars 2024

**Tiranë, më 17 Prill 2024:** Në Mars 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 33 mld lekë, duke u ulur me -21,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 3,4 %, në krahasim me Shkurt 2024. Importet e mallrave arritën vlerën 75 mld lekë, duke u ulur me 7,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 1,3 %, në krahasim me Shkurt 2024. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 42 mld lekë, duke u rritur me 8,3 %, krahasuar me Mars 2023 dhe duke u ulur me -0,4 %, në krahasim me Shkurt 2024.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë tremujor eksportet e mallrave arritën vlerën 95 mld lekë, duke u ulur me -22,3 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 209 mld lekë, duke u rritur me 0,4 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 114 mld lekë, duke u rritur me 32,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Mars 2024, në uljen e eksporteve prej -21,0 %, negativisht kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -7,2 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,8 pikë përqindje, Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,6 pikë përqindje etj.

**Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Mars 2024**




Eksportet, gjatë këtij tremujori janë ulur me -22,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -11,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -5,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -3,6 pikë përqindje, etj.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Mars 2024, në uljen e importeve prej -7,0 %, krahasuar me Mars 2023, kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,7 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -2,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,4 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,7 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +2,0 pikë përqindje.

**Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Mars 2024**



Si tremujor, importet janë rritur me 0,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2023. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,8 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +1,4 pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,5 pikë përqindje, etj.

#### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**

Në muajin Mars 2024, vendet me të cilat Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Mars 2023 janë: Maqedonia e Veriut (8,5 %), Mbreteria e Bashkuar (39,7 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (10,9 %), Kosova (15.1 %) dhe Greqia (22.6 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (11,7 %), Kosova (7,3 %) dhe Greqia (37,5 %).

Në muajin Mars 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Turqia (7,1 %), Kina (0,9 %) dhe Gjermania (7,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (1,5 %), SHBA (26,6 %) dhe Maqedonia e Veriut (27,5 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (21,6 %), Greqia (25,8 %) dhe Gjermania (10,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (3,1 %), Kina (10,0 %) dhe Spanja (5,2 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Mars 2024



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 60,3 %, të gjithë tregtisë. Në Mars 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,0 %), Turqia (8,9 %), Greqia (7,2 %) dhe Gjermania (7,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për tremujorin e parë 2024, me vendet e BE-së zënë 58,8 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Mars 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,6 %), Turqia (9,6 %), Greqia (7,3 %) dhe Gjermania (7,1 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Mars 2024

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	Janar – Mars 21	80	21,9	162	17,5	-82	49,5
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	Janar – Mars 22	120	49,6	207	27,9	-87	57,9
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	Janar – Mars 23	123	2,1	208	0,4	-86	58,9
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	Janar– Mars 24	95	-22,3	209	0,4	-114	45,6

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Mars 2024**

	Eksporte				Importe			
	Mars 2023	Mars 2024	Janar - Mars 2023	Janar - Mars 2024	Mars 2023	Mars 2024	Janar - Mars 2023	Janar - Mars 2024
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>31.716</b>	<b>24.063</b>	<b>90.168</b>	<b>71.024</b>	<b>40.731</b>	<b>41.099</b>	<b>105.980</b>	<b>107.961</b>
Austri	418	154	1.174	617	751	508	1.720	1.797
Gjermani	2.301	1.713	7.548	5.787	5.493	5.887	14.391	15.903
Greqi	2.533	1.961	9.438	5.901	5.047	5.803	12.990	16.342
Itali	18.082	16.112	51.169	45.198	17.667	17.402	46.260	44.820
Spanjë	2.430	289	5.657	2.353	1.180	1.360	3.127	2.964
Kroaci	797	434	1.811	1.413	561	284	1.547	780
Të tjera të BE-së	5.154	3.400	13.369	9.754	10.031	9.854	25.945	25.356
Mbretëri e Bashkuar	110	154	436	395	668	687	2.003	1.898
Kinë	610	605	1.924	1.535	6.792	6.853	20.627	18.568
Kosovë	3.922	3.331	10.214	9.469	870	1.007	2.682	2.666
Maqedonia e Veriut	1.322	1.434	7.254	3.403	1.428	1.036	3.375	2.753
Rusi	-	5	3	5	774	222	1.716	615
SHBA	357	317	1.263	1.066	1.690	1.239	4.257	5.550
Turqi	481	317	1.377	1.129	8.729	9.350	23.135	28.131
Ukrainë	94	52	435	165	177	351	714	1.228
Zvicër	485	204	2.096	451	2.788	854	3.993	1.945
Të tjera	3.013	2.780	7.356	6.572	15.872	12.149	39.714	37.633
<b>Gjithsej</b>	<b>42.111</b>	<b>33.264</b>	<b>122.526</b>	<b>95.216</b>	<b>80.517</b>	<b>74.848</b>	<b>208.197</b>	<b>208.948</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Mars 2024**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Mars 2023	Mars 2024	Janar - Mars 2023	Janar - Mars 2024	Mars 2023	Mars 2024	Janar - Mars 2023	Janar - Mars 2024
<b>Gjithsej</b>	<b>42.111</b>	<b>33.264</b>	<b>122.526</b>	<b>95.216</b>	<b>80.517</b>	<b>74.848</b>	<b>208.197</b>	<b>208.948</b>
Ushqime, pije, duhan	4.927	4.721	12.241	12.135	11.773	13.414	31.734	34.607
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	9.066	6.604	31.896	18.250	10.080	6.335	25.452	19.104
Produkte kimike dhe plastike	1.588	1.279	3.733	3.716	12.490	10.486	29.539	28.093
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	251	207	820	613	1.437	1.238	3.697	3.103
Prodhime druri dhe letre	1.132	870	3.117	2.487	2.787	2.495	7.154	6.809
Tekstile dhe këpucë	11.841	8.805	34.291	27.401	8.864	7.607	23.265	20.093
Materiale ndërtimi dhe metale	8.390	6.433	22.888	18.465	12.466	10.530	31.042	30.437
Makinëri, pajisje dhe pj. këmb.	3.764	3.326	10.639	9.511	17.589	19.740	47.925	57.951
Të tjera	1.153	1.019	2.900	2.638	3.032	3.004	8.389	8.751

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Mars 2024**

	Itali		Kosovë		Gjermani		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
<b>Gjithsej</b>	<b>51.169</b>	<b>45.198</b>	<b>10.214</b>	<b>9.469</b>	<b>9.438</b>	<b>5.901</b>	<b>7.548</b>	<b>5.787</b>
Ushqim. pije duhan	3.555	3.940	1.247	1.228	1.162	1.074	528	417
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	2.706	4.788	2.358	2.398	4.295	689	3.541	2.035
Produkte kimike dhe plastike	1.516	1.533	1.002	843	268	219	10	6
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	789	521	3	1	9	66	2	1
Prodhime druri dhe letre	1.881	1.346	274	295	471	348	34	36
Tekstile dhe këpucë	26.754	20.703	52	42	1.830	2.058	2.381	2.339
Materiale ndërtimi dhe metale	7.124	5.868	4.502	3.902	1.133	1.183	396	174
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	5.418	5.120	407	447	27	48	555	674
Të tjera	1.427	1.379	368	313	243	215	102	106

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Mars 2024**

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
<b>Gjithsej</b>	<b>46.260</b>	<b>44.820</b>	<b>23.135</b>	<b>28.131</b>	<b>20.627</b>	<b>18.568</b>	<b>12.990</b>	<b>16.342</b>
Ushqim. pije duhan	6.096	7.087	1.606	1.457	415	455	4.117	4.496
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	1.243	322	4.216	3.601	10	4	963	2.406
Produkte kimike dhe plastike	5.620	5.806	3.298	2.939	1.914	1.452	2.473	3.037
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.975	2.437	92	73	186	233	8	67
Prodhime druri dhe letre	1.681	1.475	1.320	1.162	359	360	874	856
Tekstile dhe këpucë	11.120	8.939	3.564	2.565	2.878	3.065	1.282	1.673
Materiale ndërtimi dhe metale	6.345	5.595	5.098	7.459	2.822	2.685	1.934	2.338
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	9.318	10.892	2.865	7.965	10.475	8.677	831	828
Të tjera	1.863	2.269	1.075	909	1.567	1.637	508	640

# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri